



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.08.2022 të parashtruar nga OE Kolegji Ndërkombëtar Për Biznes Dhe Teknologji – UBT Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Hartimi i planit zhvillimor Komunal**” me nr. të Prokurimit 613-22-6619-2-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim OE Kolegji Ndërkombëtar Për Biznes Dhe Teknologji – UBT Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Hartimi i planit zhvillimor Komunal**” me nr. të Prokurimit: 613-22-6619-2-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK i publikuara në platformën e prokurimit i datës: 19.08.2022, i propozuar për kontratë OE Instituti i Shkencës Dhe i Teknologjisë Insi SH.P.K., Prishtinë.

1. Mbetet në fuqi Vendimi i AK i publikuar në Platformën e Prokurimit i datës: 19.08.2022.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE Kolegji Ndërkombëtar Për Biznes Dhe Teknologji – UBT Prishtinë ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i planit zhvillimor Komunal” me nr. të Prokurimit 613-22-6619-2-2-1

Përgjigje për pretendimet e OE ankues:

Oferta juaj është vlersuar duke u bazuar në kërkesat e parashtruara nga ana e AK, tek pika kapaciteti teknik dhe profesional kërkesë e AK ka qenë Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme (Se paku të kryer nje Plan Zhvillimor apo Harte Zonale) në vlerë prej 120,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.

Ju si OE pjesëmarrës keni dorëzuar një listë të kontratave poashtu keni bashkëngjitur disa referenca për projekte të ngjashme por juve ju mungon se paku një kontratë me referencë për plan zhvillimor apo hartë zonale siq është kërkuar nga AK, referenca juaj me Komunen e Vitise nuk është sipas kërkesës së AK, sepse kjo kontratë është në listën tuaj poshtu edhe dëshim për të që e keni paraqitur por datat janë pas publikimit të njoftimit për kontratë dhe nuk është sipas kërkesës së AK kete mund ta verifikoni edhe vetë në dokumentet që ju keni dorëzuar.

Dëshmitë për inxhinierin tuaj z.Vehbi Sofiu ku keni paraqitur një vendim të leshuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe ceket që dega e tij e përfunduar është Megjister në menaxhimin e Mjedisit Jetësor dhe jo siq e keni cekur ju inxhinier i elektroteknikës.

Komisioni për vlersim të ofertave poentimin e ka bërë duke u bazuar në dokumentacionin tuaj dhe duke bërë krahasimin edhe me ofertat tjera pjesëmarrëse.

Pretendimet e juaja janë të pa pabazuara

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP,
Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.
Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Data: 25.08.2022

Drejtor i Prokurimit

Bekim Shabani

